



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3810 Prot.

Ballsh më, 26.07.2022

VENDIM

NR. 40 Datë 26 / 07 /2022

**“PËR
AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË MALLAKASTËR OSE TË
AUTORIZUARIT PREJ TIJ PËR LIDHJE KONTRATE PARA NOTERIT PËR
SHITJEN E TRUALLIT TË OBJEKTIT”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.2, shkronja “a), neni 23, pika 14, neni 54, shkronja “k”, neni 55, pika 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” Ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjit nr. 8744, datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, pika 4 e VKM nr. 329, datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së Ffungsionimit të Këshillit Bashkiak”, kërkesave të qytetarëve paraqitur pranë Bashkisë Mallakastër në lidhje me regjistrimin e trojeve të përfutur nga ish – Bashkia Ballsh, si dhe verifikimit të dokumentacionit të kryer nga ana e strukturave të Bashkisë Mallakastër,

VENDOSI

1. Miratimin e autorizimit të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër ose të autorizuarit ligjor prej tij për lidhje kontrate para noterit për shitjen e truallit për qytetarët si më poshtë:

Resmi Agalliu	Pasuria nr. 4/153	sipërfaqe trualli 47 m2	ZK. 1090
Piro Taullaj	Pasuria nr. 4/177	sipërfaqe trualli 100 m2	ZK. 1090
Astrit Muhametaj	Pasuria nr. 10/31	sipërfaqe trualli 324 m2	ZK. 1090
Barjam Beqaraj	Pasuria nr. 8/358	sipërfaqe trualli 264 m2	ZK. 1090
Dashnor Ahmetaj	Pasuria nr. 6/134	sipërfaqe trualli 252 m2	ZK. 1090

2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose i autorizuari prej tij për vazhdimin e procedurave për lidhjen e kontrates para noterit publik.

3. Ky vendim vendim shoqërohet me relacion shpjegues.

KRYETAR

ELITIM BARAJ

